

VENDIM
Nr. 5, datë 20.6.2019

PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME, SI DHE LISTËS SË INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJISË E DOKUMENTEVE TË INSTITUCIONEVE QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË KËTO STANDARDE

Mbështetur në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dhe germave “ë” dhe “f”, të pikës 5, të nenit 8, të VKM-së nr. 360, datë 26.4.2017, “Për miratimin e rregullores ‘Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave’”, i ndryshuar, Këshilli i Lartë i Arkivave,

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të kutive dhe dosjeve për ruajtje të përhershme për arkivat jo në veprim dhe për institucionet që ruajnë dokumentacion gjithnjë pranë tyre, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Miratimin e listës së institucioneve dhe tipologjinë e dokumenteve të institucioneve, që janë të detyruara të zbatojnë standardin e kutive dhe dosjeve për arkiva të përhershme, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Autoritetet publike mund të përdorin kuti dhe dosje me përmasa të ndryshme nga ato të përcaktuara në këtë vendim, vetëm nëse kanë marrë paraprakisht miratimin me shkrim nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave.

4. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave dhe institucionet e përmendura në këtë vendim për zbatimin e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I ARKIVAVE
Ardit Bido

SHTOJCA 1

STANDARDET E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR RUAJTJE TË PËRHERSHME PËR ARKIVAT JO NË VEPRIM DHE PËR INSTITUCIONET QË RUAJNË DOKUMENTACION GJITHNJË PRANË TYRE

Lloji	Përmasat	Standardet
Kuti për ruajtje të përhershme	40x28x18	Përveç standardeve të kutive dhe dosjeve normale, duhet të jetë edhe:
Kuti për ruajtje të përhershme për amza	40x55x18	- Ndërtuar nga karton i fortë e i valëzueshëm. - Faqet anësore me fortësi të dyfishtë, faqet fundore me trashësi të dyfishtë. - Të ketë një pH midis 7.0 dhe 9.5.
Kuti për ruajtje të përhershme për regjistra	40x70x9	- Të përmbajnë një rezervë alkaline minimale prej 2% të karbonatit të kalciumit. - Të përmbajnë jo më shumë se 1% lignin
Dosje për ruajtje	37x26	-Të jetë e bërë nga fibra celuloze (pambuku ose pulpë druri e

të përhershme	pastruar) Nuk duhet të ketë shtresa ngjitëse ose të kapura.
---------------	--

SHTOJCA 2

LISTA E INSTITUCIONEVE DHE TIPOLOGJIA E DOKUMENTEVE TË INSTITUCIONEVE, QË JANË TË DETYRUARA TË ZBATOJNË STANDARDIN E KUTIVE DHE DOSJEVE PËR ARKIVA TË PËRHERSHME

1. Arkivat shtetëror të sistemimit, tipologjisë dhe institucionet e pavarura Kushtetuese, që sipas ligjit i ruajnë dokumente përherë pranë tyre.
2. Institucionet qendrore e të varësisë, si më poshtë:
 - a) Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (Regjistra të gjendjes civile; Regjistra të lindjes dhe vdekjes; Regjistra për martesat dhe zgjidhje të martesave etj.);
 - b) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë (Kartoteka);
 - c) Drejtoria e Përgjithshme e Pronësisë Industriale (Dosjet me dokumentacion tërësor, për patentat, licencat, mbrojtjen e të drejtës së autorit që ruhen mbi 50 vjet);
 - d) Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (Regjistra të lejeve të drejtimit, qarkullimit dhe mjeteve të transportit);
 - e) Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Regjistra të subjekteve tatim-pagues që ruhen mbi 50 vjet);
 - f) Instituti i Sigurimeve Shoqërore (Librat e pagave, Bordero etj.);
 - g) Agjencia Shtetërore e Kadastrës (Dokumente për regjistrimin, shqyrtimin dhe verifikimin e pasurive të paluajtshme që ruhen mbi 50 vjet, regjistra etj.);
 - h) Spitalet Universitare dhe Rajonale (Kartelat shëndetësore që ruhen mbi 50 vjet);
 - i) Institucionet e Arsimit të Lartë dhe Parauniversitar (Regjistrat e amzave, librat e indekseve etj.).
3. Institucione të tjera që ruajnë e administrojnë dokumente tipologjike mbi 50 vite, i kërkojnë Këshillit të Lartë të Arkivave, përfshirjen në këtë vendim.